

Procesverbal

*Nga Mbledhja III (e tretë) e rregullt për vitin 2025 e Komitetit për Politikë dhe Financa ,
e mbajtur më datë: 07.04.2025*

Rend Dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për seancën e tretë të rregullt; dhe
3. Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje kolegë delegatë, përfaqësues i OSBE-së dhe ju të pranishëm të tjerë! Mirë se erdhët në Mbledhjen e tretë të rregullt të KPF-së për vitin 2025. Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë, ku i kemi tri pika të rendit të ditës dhe materialin për seancën e tretë, ku janë paraparë tetë pika të rendit të ditës. Mirëpo, pika e shtatë e rendit të ditës, që ka të bëjë me shqyrtimin e kërkesës së Fero Kromit, këtë pikë do të heqim nga rendi i ditës, pasi që dje kemi pas një takim me banorët e fshatit Shajne, unë si kryesuese dhe kryetari i Komunës. Në asnjë mënyrë nuk jemi kundër vullnetit të banorëve të fshatit Shajne, andaj këtë pikë do ta heqim nga rendi i ditës. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës së KPF-së, mundeni me e marrë fjalën.

Artan Loshaj: Mirëmëngjesi për të gjithë! Rreth rendit të ditës – kryesuese – unë nuk e di tash pse e hiqni prej rendit të ditës, mos mendoni se jam kundër qytetarëve të fshatit Shajne, ne gjithmonë kemi qenë për investitorët, por edhe për me e mbrojt qytetarin. Por, ju është dashtë me kohë, unë kam qef me e lënë në rend të ditës – jam kundër, do të votoj kundër, kemi pas me votue kundër edhe si PDK, edhe si Artan – po duhet me e lënë nesër, në Komitet të diskutohet, edhe t’u kërkohet falje qytetarëve, se në mënyrë tinzare e keni qit në rend dite, pa e qit në dëgjim publik, pa u njoftue qytetarët, edhe në mënyrë tinzare keni shkue në Shajne, edhe po doni me e hek. Neve 34 faqe material na keni pru me lexue me orë të tëra, edhe në fund rezultati zero me zero. Edhe një herë të jam i qartë: jam kundër të bëhet ajo fabrikë, por jam pro që nesër të jetë në rend dite, ta diskutojmë, t’u kërkoni falje qytetarëve, e jo në mënyrë tinzare qit në rend dite, në mënyrë tinzare hiq prej rendit të ditës. Kjo për mu është e papranueshme.

Munir Jonuzi: Pershendetje te gjithëve. Jam dakord me kolegun Artan që kjo pikë të lihet në rend dite. Por unë për arsye krejtësisht të ndryshme. Le të diskutojmë këtë pikë të rendit të ditës dhe ta hedhim poshtë. Qe të mos përsëritet kjo kërkesë në 6 muajt e ardhshëm? Nëse e shtyjme tani këtë pikë të rendit të ditës, mund të shfaqet në një nga seancat e ardhshme dhe do të kemi sërish të njëjtat probleme. Më

së miri është ta lëmë në rend te dites dhe të jemi të gjithë kundër këtij investimi.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Edhe Artani, edhe z.Munir thanë që kjo pika të jetë në rend dite dhe të diskutohet. Unë dje me banorët e fshatit Shajne që kam mbajtur takim, ata jo që kanë kërkuar – a po e doni vullnetin e qytetarit – vullneti i qytetarit ishte që nesër as mos të diskutohet ajo pikë edhe unë kështu u kam premtuar. Edhe Artani tha që është tinëzare. Asnjë pikë nuk qitet tinëzare. E para, e dyta: me kryetarin e Komunës kemi qenë, kjo nuk është tinëzare, kanë qenë 200 banorë. Ke mund, Artan, edhe ti me ardhë me marrë pjesë. Je edhe asambleist, ndoshta edhe ke marrë vota në Shajne. Ajo ka qenë publike, absolut tinëzare nuk ka qenë. Ku e ke pa ti tinëzaren këtu, kur fshati Shajne e ka qit, e ka qit kryetari i Komunës. Unë nuk po di qysh ma ndryshe. A mundesh me ma shpjegue qysh është tinëzare? Bile ti u desht me marrë pjesë, për arsye se kryesuesja të ka ardhë, po e lëmë ekzekutivin. Mos bën këso propaganda – tinëzare, tinëzare. Bash jam t'u e qit personale, se shumë po bëni politikë, vetë PDK-ja keni dalë me reagim, vetë VV-ja keni dalë me reagim. A po duesh vullnetin e fshatit Shajne – e kemi edhe Billallin – fshati Shajne ka kërkuar prej meje që ajo mos të jetë pikë e diskutimit. Edhe e kam atë drejtë ligjore, edhe e qes pikën e rendit të ditës, edhe e heki vetë. Gjithmonë e ke mësue këtë fjalën, s'po ma japish fjalën, po e qesish personale. Këtu kur të vjen puna edhe personale i qesim. Kjo nuk është tinëzare, a budall po e bëjsh një opinion ti, a? Unë jam kryesuese, e përfaqësoj Asamblenë, vetë më ke votuar me e udhëheq. Edhe ti ia ke nis fushatës, ti ia ke nis shumë moti. Mos po duesh personale hala? Hala je t'u bo personale, edhe në fshat bile je t'u bo, po s'po të ec. Ta shohim, unë prapë kam me qenë këtu.

Artan Loshaj: Para se me nis me folë, nëse duesh me folë, fol, e mos ma ndërprej fjalën si qysh e ke zanat! Me pas qenë në të mirën e qytetarit, ju me kohë nuk e kishit qit në rend dite. E kishit thirrë dëgjimin publik, i kishit thirrë banorët e Shajnes në Kuvend, ku bëhet kuvendi. E jo në mënyrë shumë tinëzare me shkue – se qytetarët e fshatit Shajne e kanë thirrë takimin me kryesinë e fshatit, me qytetarët e fshatit, edhe me e zgjedhë kryesinë e re. Ua keni imponuar që me shkue në Shajne. Keni pas me çue edhe investitorin, keni pas smart drejtorin e juaj, drejtorin e Ekonomisë. Nuk jau kanë pranuar as investitorin, nuk jau kanë pranuar as Qamilin, edhe e keni pas vetë çfarë pritje ju kanë bo ata. Ju, me pas desht qytetarin, i kishit thirrë këtu, e jo me shkue në Shajne atje. Kur e keni pa që sharra në gozhdë ju ka zënë, kur e keni pa që kanë qenë në mënyrë kategorike ata që mos me qenë në rend dite, atëherë keni marrë keni shkue – se s'po due me e qit personale, po më detyrosh – keni marrë në Facebook ke shkruar fjalë miradie, qytetarët e Shajnes janë mikpritësa, dëshmorët, e ato, e këto, keni nis me bo parafushatë herët, gjashtë muaj përpara. Aty nuk ka pas nevojë hiç ju me shkue, ka pas nevojë ju me e thirrë qetu. Edhe për ato të AKP-së që i qitëm, o kryetar, gabim e kështu se ato janë të shtetit, po i qitni. Pesë pikat jau kthyen prapë, Domethënë, ju bëni një herë hop, masnej e qitni këmbën. Herën tjetër, në mënyrë të qetë, të butë, mësohnu, bare ti mësohu, kryetar, se ke qenë gjatë në pushtet, një herë kqyrni anët ligjore,

kqyrni qytetarët, kqyrni ankesat. E keni qit në mënyrë ekstrem tinëzare, po shkoni në fshatin Shajne, po shkon kryetari. Kërkush nuk ju ka thirrë juve. Ju keni shkue vetë atje, me e zbut gjendjen, me jau kallxue projektin. Kjo në Shajne nuk kalohet. Shajnast kanë ditë edhe në kohë luftime me i ndalë të këqijat, po edhe në kohë paqeje i ndalin. E aty me fjalë miradie, dëshmorët, e mikpritësa, e shumë të buzëqeshur, nuk kanë qenë të buzëqeshur, kanë qenë të mrrolur qytetarët, ju kanë prit me zor, me zor, me zor ju kanë folë, me zor ju kanë prit, edhe pak e keni relaksue gjendjen. E ju që doni me bo politikë në emër të kësaj, edhe një herë ju thashë, ju ka zënë sharra në gozhdë, edhe tash në Komitet po e qesish me e hek ti nesër. Ti nesër e hekish me vota, këtu mundesh si propozim me e dhënë në Komitet, se për me e hek si s'un e hekish. Për me e hek nesër duhet me qenë pikë e rendit të ditës në Kuvend, e qesim propozimin tënd për me e hek, i marrish votat, edhe do ta hekim. Ama, nesër duhet me u kërkue falje qytetarëve, me u thënë që ju, të nderuar qytetarë, kemi gabue – burrëni është me thënë kemi gabue – nuk ju kemi pyet, e kemi pa që s'po kalon. Tymi nuk kalon në Shajne, mbeturinat nuk kalojnë në Shajne, dallaveret nuk kalojnë në fshatin Shajne.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Sa për takimin, na kanë prit shumë mirë. Unë për veten time, personalisht, flas. Absolut. Hala nuk kam marrë unë brohoritje më të madhe edhe dashuri prej fshatit Shajne. Janë këtu shajnast. Por, që s'na kanë prit në Shajne, kjo nuk është e vërtetë. Kryetari i Komunës ja lyp të premtën me pas takim, edhe kryesia e fshatit ka thënë që a ka mundësi, që të dielën ne do ta mbajmë takimin, je i mirëseardhur atë ditë, por nëse duesh edhe të premtën. Kjo pikë nuk do të diskutohet. Në qoftë se ke – Uran – diçka për pikat e rendit të ditës të KPF-së, mundesh me e marrë fjalën. Nëse nuk ke rreth rendit të ditës, e lëmë në pikat në vazhdim.

Uran Halimi: Ju përshëndes së pari të gjithëve! Ne ishim duke folë për pikën e rendit të ditës, që u propozue për me u largue, a po? Por ti thaje që e kemi pikën e shtatë që duhet me e largue, qaty u kapëm na edhe po debatojmë për pikën e shtatë që duhet me u largue. Nse je mendoni që duhet me u largue, duhet me e propozue për me u largue ajo, edhe kalon me shumicë të votave propozimi, ose nuk kalon. Tjetra është që kemi reague, normal që ne reagojmë, na kanë kërkue qytetarët për me reague edhe s'diskutohet që reagoj. Mikpritja ose pritja në Shajne është e 9 shkurtit, znj. Arijetë, ju ka kallxue Shajnja qysh ju pret. Mirë që po largohet, mirë që jeni zbut. Çka me thënë tjetër send, s'po foli ma shumë se po dal jashtë kornizave, e s'të pëlqen.

Artan Loshaj: Masi ke kërkue ti pikën e shtatë me e hek, unë po kërkuj që në pikë të rendit të ditës të jetë propozimi im i seancës së kaluar, që ma keni refuzue, edhe ti që ke premtue që je shumë pro, me e shti në rend të ditës diskutimin për sindikatën e shëndetësisë. Nesër, nëse e hekim të shtatën, me e shti kërkesën e sindikatës së shëndetësisë në rend dite. Ta lëshoj, në minutën e gjashtë ke premtue, jam shumë pro, do ta diskutojmë, nuk e di për një muaj ditë a e ke diskutue me kryetarin, a e ke diskutue me kryetarin e sindikatës. Unë kërkuj që nesër – si Komitet, propozoj – që nesër në seancë të jetë pikë

e rendit të ditë sindikata e shëndetësisë. Edhe kam qef me m'njoftue – që ka mundësi nesër – çka u bo me sindikatën e Komunës, a ju ka kthye pozitivisht, apo negativisht. Edhe një herë, kërkoj që nesër në seancë të jetë si pikë e rendit të ditës kërkesa e sindikatës së shëndetësisë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Ne atë ditë e patëm që, në qoftë se na vjen ajo kërkesa e Administratës pozitive, kemi mendue që do të vjen në këtë muaj edhe këtë muaj kam pas me e qit kërkesën e shëndetësisë. Por, pasi ajo nuk na ka ardhë deri atë ditë kur i kam bërë pikat, edhe nuk është hala sot. Por, nesër si kërkesë ti mundesh me e qit prapë edhe mundim me e qit në votim. Por, pika e shtatë nuk do të hyjë në diskutim, të gjithë banorët e fshatit Shajne kanë thënë që të mos jetë asnjë diskutues. Po ti mundesh me e marrë nesër fjalën, edhe me dalë me thënë banorët nuk na caktojnë çka me folë. Unë kam folë me zyrtarin ligjor, kryesuesja ka të drejtë me e hek, edhe e kam premtue një gjë të tillë dje në fshatin Shajne.

Xhylferie Bahtijari Beqiri: Përshëndetje për të gjithë! Vetëm deshta me u kyç me pjesën e pikës së rendit të ditës, që Artani propozoi me e shti në rend të ditës. Për çudi, në shumicën e rasteve kemi ankesa lidhur me futjen e pikave të rendit të ditës kështu, me parashutë që i themi. Vetë po kërkoj tash. Pse, për shembull, që një muaj ke kërkuar, ke kërkuar edhe muajin e kalum, në seancën e kalume, me e shti në rend të ditës. Qe një muaj, për çka nuk ke bo kërkesë të rregullt edhe me e shti normal me pikat. Tash edhe kryesuesja e dha përgjigjen për atë, nuk deshta masnej me dalë, por që deshta me e cek këtë çështjen e e pikave të rendit të ditës. Po ankoheni për neve, që zakonisht ne po fusim pika të rendit të ditës pa u konsultue paraprakisht. Po e shoh që po e ndiesh kënaqësinë që ta përmenda emrin për me dalë me bo replikë. Faleminderit!

Artan Loshaj: znj.Xhylferie, për respektin që kam, keni nis edhe ju si herët fushatën. Kërkesa ime ka qenë në rend dite, edhe unë po due me i kursye kolegët asambleistë që janë punëtorë shëndetësorë, se nesër live shihet seanca – edhe kur e kam pa poztien që e ngren dorën kundër kolegëve, mu më ka ardhë siklet edhe thashë mos janë bo pishman e mos po votojnë këtë herën. Edhe znj.kryesues ka thënë jam shumë pro – pro, dy herë e ka përmend – për këtë pikë dhe në seancën e radhës do të jetë pikë e rendit të ditës. Unë po due me ia kujtue kryesueses, se unë nuk e bëj rendin e ditës. Kryesuesja me kryetarin e bëjnë rendin e ditës – edhe unë s'kam pas mundësi qysh me e bo, mundësia ime është Komiteti edhe seanca, se unë rend dite nuk bëj. Kur e lexova materialin, prita edhe sot mos po thotë kryesuesja, këtë shtatshin që po e hekim, po e shtimë këtë, po jo. Thashë t'ia rikujtoj fjalët e kryesueses, që edhe kryetari është shumë pro, s'paku nuk kanë diskutue këta me kryetarin e sindikatës, se këta kanë thënë do të bisedojmë, duhet me marrë vendime. Vendim i madh me marrë për ose kundër. E të dal në muhabetin e xeheve, hiç s'kanë diskutue. A është dashtë ajo – bajagi me miliona – është dashtë shumë, këta për një punë të vogël tre muaj ditë diskutojnë, se punë e madhe a me e shti a jo, a po bëjmë mirë a jo, se duhet m'i kalkulue votat tash. Me jau dhënë, sa janë me ne, mos me jau dhënë, atho çka po bëjnë. Edhe kjo e sindikatës së Komunës është e qëllimshme, se në qoftë se për 30 ditë – unë sa e di, nashta edhe

gaboj – nuk vjen përgjigjja, ata në heshtje e pranojnë si pozitive. Bajagi do sende i kam lexue, i kam pa. Unë thashë juve mos me ju qit keq, valla po kam qef edhe një mandat me e marrë. Shumë kam qef edhe një mandat me e marrë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Kryesuesja ka thënë që unë jam pro, por në një seancë tjetër, në seancën e radhës. Por, kam thënë që presim me ardhë pozitive a Administratës, atëherë do ta thirri kryetarin e sindikatës edhe do ta diskutojmë. Mundish me e qit nesër. Atëherë, e qesim në votim. Kush është pro rendit të ditës së KPF-së? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë procesverbalin. Atëherë, fillojmë te pika e dytë: Propozim-vendimi për bartjen e mjeteve vetanake të pashpenzuara nga viti 2024 në vitin 2025. A do dikush me e marrë fjalën?

Munir Jonuzi: Përshëndetje të gjithëve. Kam shumë pyetje. Kur shikojmë shumën totale të mjeteve të papërdorura që na kanë mbetur në dispozicion, arrijmë në përfundim se këtë vit ajo shumë është më e ulëta. Vetëm 87,000 euro. Do t'i bëj disa pyetje drejtorit të financave. A mund të na shpjegoni se si kemi arritur në këtë shumë prej 87,000 euro? Ju në raportin vjetor keni treguar se si kemi ardhur deri te kjo shumë. Mua më intereson konkretisht. Ju keni shkruar se për nevojat e ujësjellësit janë shpenzuar 8,500 euro. 90,000 euro për mirëmbajtjen e rrugëve lokale — cilat rrugë janë përfshirë në këto shpenzime? Nuk më interesojnë shpenzimet e komunës në përgjithësi, por dua të di konkretisht për çfarë janë shpenzuar 288,000 euro nga të hyrat vetanake gjatë vitit 2024, projekt për projekt. Ujësjellësi qendror 8,500 euro, mirëmbajtja e rrugëve lokale p.sh. 30,000 euro — në atë kontekst. Shpesh kemi paqartësi lidhur me mjetet që ka marrë përmbaruesi privat. Që të mos keqkuptohem, ju lutem të na dorëzoni një listë nga cilat mjete janë marrë fondet nga përmbaruesi privat. Shuma është shumë e madhe, rreth 600,000 euro. Prej tyre, 150,000 janë të ardhura vetanake. Për kryetarin: shoh që përsëri keni anashkaluar projektin për ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Rapçë. Në atë projekt kemi investuar rreth 50,000 euro. Tani nuk mund ta përfundojmë për shkak të mungesës së 10,000 eurove. Ju kam dërguar kërkesë, nuk e di nëse ato kërkesa arrijnë te ju. Mendoj se kërkesat e mia nuk arrijnë, sepse asnjëherë nuk kam marrë përgjigje, përveç një herë. Duhet të investojmë 14,000 euro për renovimin e QKMF-së, ju thoni që ky projekt ishte edhe vitin e kaluar, dhe kjo është e vërtetë — kemi ndarë mjete përmes relokimit, rreth 14,170 euro. Vazhdimi fjalisë krijon konfuzion, thoni se nuk është ndryshuar struktura. Nëse shohim se sa mjete janë ndarë — janë të njëjtat mjete që janë ndarë edhe këtë vit. Një tender në fund të muajit nëntor tregon se sa seriozë janë drejtori i shëndetësisë dhe ai i urbanizmit. Kemi ndarë mjetet në prill, tenderi është shpallur në nëntor. Nuk kam informacion që ndonjë kompani e ka marrë atë projekt. Mendoj se ato mjete prej 14,000 euro janë humbur. Në çfarë e bazoni

optimizmin? Nëse vitin e kaluar ato mjete janë humbur, pse mendoni se këtë vit do të kemi sukses? E dimë që çmimi i materialeve po rritet çdo vit.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e tretë: Propozim-vendim për rialokimin e mjeteve të Buxhetit për vitin 2025. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë te pika e katërt: Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për shpalljen e Listës së Përgjithshme dhe të Veçantë të pronës së paluajtshme të Komunës për vitin 2025. . A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e pestë: Propozim-vendim për emërimin e Komisionit për Përzgjedhjen e Drejtorëve në Institucionet Edukativo-Arsimore në Komunën e Dragashit. . A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, 1 kundër dhe zero abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e gjashtë: Propozim-vendim për anulimin e vendimeve për shpalljen e interesit publik: 01Nr. 060/01-3240-1/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-2/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-3/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-4/25 i datës 28.02.2025; 01Nr. 060/01-3240-5/25 i datës 28.02.2025. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: Këtë e kemi ditë në fillim që ka me u kthye prapë, ia kemi thënë kryetarit. Por, pse Artani diskuton edhe pse e ka mirë, për inat të nuses ishalla më vdes djali. Unë si asambleist kërkoj që të jetë prapë pikë e rendit të ditës kjo. Ose, në qoftë se e keni pas me seriozitet për me i marrë, na nuk po heqim dorë, prapë po i lomë si pikë e rendit të ditës, na po e votojmë, prapë le të na kthejë Ministria prapë. Po i marrim me zor, po. Se s'keni desht me ngue, s'po ngoni, po mendoni se e keni mirë. Unë po kërkoj që të jetë pikë e rendit të ditës edhe nesër t'i votojmë, edhe një herë Ministria le të na kthejë prapë.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese, zv/kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së! Të nderuar drejtorë, përfaqësues të OSBE-së, të pranishëm të tjerë! Kësaj seance të Komitetit i dëshiroj sukses! Lidhur me pyetjen që e bëri Artani, ne i kemi dërgue këto dhe Asambleja i ka votue, por paralelisht, unë si kryetar i Komunës i kam dërgue të njëjtat kërkesa edhe në ministrinë përkatëse, dhe shumë shpejt na kanë ardhë përgjigjet si pozitive, dhe është kërkuar, neve na është lënë në kompetencë të Komunës të përgatitim elaboratin e këtyre parcelave dhe pastaj t'i çojmë në ministri dhe do t'i realizojmë këto kërkesa. Domethënë, ne nuk kemi humbur asgjë, për arsye se edhe në ministrinë përkatëse nuk e kanë të qartë çështjen e shpronësimit, kështu që ata na kanë thënë me e ndjek një rrugë tjetër. Por ne, paralelisht,

ende pa na ardhë përgjigjja, i kemi dërgue të njëjtat kërkesa në MAPL edhe na janë kthye kërkesat pozitive. Ne do ta formojmë tash komisionin për përgatitjen e elaboratit dhe këto kërkesa do të realizohen. Faleminderit!

Artan Loshaj: Kryetar, domethënë unë mirë e paskam, sa e kuptova? Po u dukka me rrit në rend të ditës, se thaje ti duhet me e bo një elaborat e me e çue prapë edhe një herë. Domethënë, edhe ti s'po tërhiqesh prej këtij vendimi? A do ta lëmë nesër me i hek këto, a me vazhdue? Po, edhe po i marrim në pronë të Komunës? Po mirë, qashtu, në rregull. A po e shohish, ia paskam godit një herë.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 4 vota pro, zero kundër zero dhe abstenim, e miratojmë edhe këtë pikë. Vazhdojmë me pikën e tetë: Përgjigjet e ekzekutivit për pyetjet e parashtruara nga asambleistët. Është për nesër kjo. Kryetar, a je nesër gati që ke me iu përgjigj pyetjeve? Okej. Atëherë, pika e fundit është pika eventuale.

Munir Jonuzi: Pershendetje te gjithëve. Pyetjet iu drejtuan drejtorëve. Kryetari i udhëheq të gjithë. Do të preferoja nëse drejtorët do t'u përgjigjeshin pyetjeve. Le të dëgjojmë përgjigjet e tyre dhe të zhvillojmë një diskutim me ta.

Bexhet Xheladini: z.Muniri në seancën e kaluar m'i ka bo disa pyetje me shkrim. Për shkak se seanca u zgjat shumë, nuk pata mundësi me iu përgjigj. Kështu që, ne kemi qit pikë të posaçme që drejtorët dhe kryetari do t'i u përgjigjen pyetjeve të asambleistëve të cilat i keni parashtruar në seancën e dytë. Ndërsa, në pikën eventuale kur të vjen, prapë ndoshta keni pyetje tjera, nëse ka kohë do t'ju përgjigjemi aty për aty, nëse nuk ka ju përgjigjemi në seancën tjetër. Kështu që, nesër edhe drejtorët do të jenë këtu, edhe do t'u përgjigjen pyetjeve të cilat i keni bërë në seancën e kaluar.

Artan Loshaj: Pyetjet po i lëmë nesër, kryetar, po e kam një lutje, kryesuese, për ty. Unë kur të vij në Komitet, debatet me kryetarin edhe me kryesuesen edhe me kolegët kam të drejtë me i bo. Mundësisht, me na formue një klimë të mirë këtu, shikuesit, drejtorët, këta tjerit mos me na ndërhy shumë. Kot e kanë këta smart drejtorat me na provokue, se e kanë problem me na qit taktit, ani se pak folim me eufori, prapë e mbajmë nivelin. Edhe një kërkesë për kryearin. Qeta drejtorat e CDU-së, bre, s'po të rrinë. Behari edhe Beani si shpesh po ikin. Edhe bash shumë pyetje kemi për ta nesër. A ka mundësi me të lut – se në seancën e parë i ke thirrë krejt, nuk janë përgjigj ata. Behari edhe Beani të kanë ikë. A ka mundësi nesër me qenë Behari, Beani edhe krejt drejtorët, bare në eventuale, s'është e thënë me rrit tanë ditën, kur të vjen puna e eventuales le të vijnë pak le të jenë prezentë dhe të marrim naj përgjigje prej tyre. Se po më vjen se diqysh si po ju injorojnë edhe juve, edhe neve, s'po më vjen shumë mirë. Për shkak të meje? Pse, kryetar? Po për çka jemi na këtu, a mos jemi në xhami a? Për Zotin, nëse është qashtu puna, kam me fjet qetu, veç mos t'i shoh ata këtu. Se kam qef edhe mos me i pa edhe në Komunë, po ngat jemi.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Atëherë, deshta me u lidhë edhe unë në këtë pikë. Kryetar, a dojnë ata, a s'dojnë me na pa, ne jemi të zgjedhurit e popullit. Absolutisht, shumica s'dojnë me na pa bile këtu edhe që ekzistojmë, por nuk është mirë ajo përgjigja që një asambleist nuk do me e pa një drejtor. Ne jemi qeta asambleistat që ia kemi votue Statutin edhe ia kemi bo të gjitha. Kështu që, është mirë, siç tha edhe Muniri, ato përgjigjet – ndoshta ka edhe përgjigje për shëndetësinë – është mirë që drejtori i Shëndetësisë me qenë këtu. Pse mos me qenë, ne kemi nevojë edhe për pyetje, edhe për çdo gjë që na intereson. Ne jemi të votuarit që na kanë pru ata për me marrë përgjigje prej atyre, ju pëlqen apo nuk ju pëlqen. Neve bile nuk po dojnë edhe këtu me na pa, por neve na ka zgjedhë populli. Kënd nuk e ka zgjedhë, e kanë qit jashtë. Ne kemi të drejtë edhe është mirë që drejtorët nesër të jenë në pikën eventuale. A do dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e mbyllin KPF-në!